



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

---

Numri i lëndës: 2018:020547

Datë: 28.05.2024

Numri i dokumentit: 05746330

**P.nr.16/16**

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA NË KAÇANIK**, Departamenti I Përgjithshem, Divizioni Penal, gjyqtarja Zajrete Muhaxheri me bashkëpunëtorin profesional Ismajl Kuçi, në lëndën penale, ndaj të pandehurit L.N nga fsh....-Kaçanik, për shkak të veprës penale, Vjedhje e rëndë e mbetur në tentativë nga neni 327 par.1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.nr.1212-2/14 të datës 14.01.2016, jashtë shqyrtimit gjyqësor, më datë 28.05.2024 mori këtë

**A K T V E N D I M**

**HUDHET** Aktakuza e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.nr.1212-2/14 e datës 14.01.2016, ndaj të pandehurit L. (E...) N. nga fsh....-Kaçanik, I lindur me dt....., me nr.personal:..., për shkak të veprës penale, Vjedhje e rëndë e mbetur në tentativë nga neni 327 par.1 lidhur me nenin 28 të KPK-se, për shkak se është shkaktuar ndalesa absolute për ndjekje penale.

I dëmtuarit B. B. nga fsh....-Kaçanik, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Shpenzimet e procedurës bijnë në ngarkim të mjeteve buxhetore të gjykatës.

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Ferizaj, ka ngrit aktakuzën PP.nr.1212-2/14 të datës 14.01.2016, kundër të pandehurit L.N nga fsh...-Kaçanik, për shkak të veprës penale, Vjedhje e rëndë e mbetur në tentativë nga neni 327 par.1 lidhur me nenin 28 të KPK-së.

Gjykata konstatoi se vepra penale, Vjedhje e rëndë e mbetur në tentativë nga neni 327 par.1 lidhur me nenin 28 të KPK-së, është kryer me datë 22.04.2014.

Sipas nenit 106 par.1 nënpar.1.4 të KPK-së, ( 04/L-082), për veprën penale, Vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 të KPK-së, është paraparë afati i parashkrimit prej 5 vite, ndërkaq sipas nenit 107 par.8 të KPK-së, është paraparë se ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së parashkrimit.

Prandaj në bazë të kësaj, gjykata konstaton se për veprën penale, Vjedhje e rëndë e mbetur në tentativë nga neni 327 par.1 lidhur me nenin 28 të KPK-së, me datë 22.04.2024, ka arritur afati i parashkrimit.

Meqë nga dita e kryerjes së veprës penale dhe ditës së marrjes së këtij aktvendimi kanë kaluar më tepër se dhjetë vite, gjykata ka gjetur se ekzistojnë shkaqet për hudhjen e aktakuzës sepse është shkaktuar parashkrimi absolut i ndjekjes penale.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit në contest civil u mor konfor nenit 462 par.2 të KPP-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është i bazuar në dispozitën e nenit 449 të KPP-së.

Nga sa u tha u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ**

**DEGA KAÇANIK**

**P.nr.16/16 datë 28.05.2024**

Bashkpunëtori profesional  
Ismajl Kuçi

Gjyqtarja,  
Zajrete Muhaxheri

**Këshilla juridike:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 3 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj Gjykate.